



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 400/2 Prot

Tiranë, më 16.4.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.15, datë 16.4.2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN E BASHKISË KUKËS DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR RREGULLIMIN E LIGJSHMËRISË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin e Bashkisë Kukës,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 128, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në Bashkinë Kukës”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e ligjshmërisë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike për administrimin e procesit të rekrutimit dhe të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 949/1 prot., datë 20.12.2024 të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kukës me shkresën nr. 949/2 prot., datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Kukës”*.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kukës, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 400 prot., datë 21.3.2025, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 2064 prot., datë 8.4.2025, protokolluar pranë komisionerit nr. 400/1 prot., datë 9.4.2025, ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, duke e analizuar në mënyrë të hollësishme skemën e strukturës dhe në përfundim ka lënë detyra konkrete në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, bazuar në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr.1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 02.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*,

të cilët janë akte rregullative, që kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, eficiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të Pozicioneve të Shërbimit Civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshkrimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate përfundimtare në lidhje me këtë proces, pasi organet e ngritura nuk e kanë finalizuar punën e tyre me një akt konkret.

Konstatohet se nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- në planin vjetor nuk janë pasqyruar **a)**nevojat për rekrutim të cilat janë krijuar gjatë vitit, si edhe **b)**nuk është evidentuar numri dhe pozicioni konkret për nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, që mund të plotësohet edhe me kandidatë të tjerë që nuk janë pjesë e shërbimit civil.
- në **56** raste, nuk janë zbatuar procedurat ligjore për të plotësuar pozicionet e punës që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë me korrektësi kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, ashtu si është evidentuar edhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Bashkia Kukës, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Kukës, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, sipas renditjes nominale që do të evidentohet në vijim, klasifikuar sipas klasës së nëpunësisë civile:

A. Emërime në kundërshtim me ligjin në nivelin ekzekutiv, **33** raste:

- Lediana Ramallari, emëruar me urdhërin nr. 132 datë 9.2.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialiste e Auditit të Brendshëm*”, në Bashkinë Kukës;
- Irena Metalia, emëruar me urdhërin nr. 110 datë 9.2.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialiste e Auditit të Brendshëm*”, në Bashkinë Kukës;
- Besjana Hallaci, emëruar me urdhërin nr. 67 datë 26.1.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Hartimit të Projekteve*”, Drejtoria e Projekteve edhe Rinisë, në Bashkinë Kukës;
- Kastriot Axhami, emëruar me urdhërin nr. 146 datë 6.3.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist Për Koordinimin Europian*”, Drejtoria e Integritetit Europian Diasporës dhe Emigracionit, në Bashkinë Kukës;
- Blerina Elezaj, emëruar me urdhërin nr. 579 datë 11.9.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i të Ardhurave*”, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Ermira Grenazi, emëruar me urdhërin nr. 325 datë 4.6.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i të Ardhurave*”, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Liljana Zeneli, emëruar me urdhërin nr. 418 datë 5.7.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Borxhit*”, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Inva Peca, emëruar me urdhërin nr. 176 datë 18.12.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Borxhit*”, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Denis Noka, emëruar me urdhërin nr. 166 datë 14.2.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Kontrollit të Territorit*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Gentiana Ismailaj, emëruar me urdhërin nr. 324 datë 4.6.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Kontrollit të Territorit*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Nezir Sopaj, emëruar me urdhërin nr. 627 datë 21.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për Planifikimin e Territorit*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Sibora Cejku, emëruar me urdhërin nr. 45 datë 19.4.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për Planifikimin e Territorit*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Roland Cengu, emëruar me urdhërin nr. 672 datë 27.12.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Pronave*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Kukës;
- Sonila Ollomani, emëruar me urdhërin nr. 19 datë 13.1.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për Akuakulturën dhe Menaxhimin e Peshkimit*”, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, në Bashkinë Kukës;
- Denis Cenaj, emëruar me urdhërin nr. 318 datë 31.5.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist*”, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, në Bashkinë Kukës;

- Artan Braha, emëruar me urdhërin nr. 115 datë 6.2.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Inspektor i Pyjeve*”, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Kukës;
- Mirjet Ramallari, emëruar me urdhërin nr. 572 datë 19.2.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Pyjeve*”, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Kukës;
- Ilmi Peposhi, emëruar me urdhërin nr. 114 datë 4.6.2021 të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist Mjedisi*”, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Kukës;
- Besarta Sylja, emëruar me urdhërin nr. 56 datë 18.1.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Etleva Zela, emëruar me urdhërin nr. 95/2 datë 1.2.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Elena Shehu, emëruar me urdhërin nr. 606 datë 13.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Shërbimit të Kujdesit Shoqëror*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Dafina Bileri, emëruar me urdhërin nr. 608 datë 14.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për çështjet e Strehimit Social*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Ledi Shehu, emëruar me urdhërin nr. 412 datë 3.7.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist e Shpenzimeve*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Granilda Kolici, emëruar me urdhërin nr. 954 datë 6.12.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Shpenzimeve*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Skënder Haxhiu, emëruar me urdhërin nr. 23 datë 8.1.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Buxhetit*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Hasije Domi, emëruar me urdhërin nr. 620 datë 19.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist Menaxhimi të Pronave Publike*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Suzana Oruci, emëruar me urdhërin nr. 163 datë 13.3.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kukës;
- Valbona Hoxha, emëruar me urdhërin nr. 654 datë 20.12.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kukës;
- Rezarta Thaci, emëruar me urdhërin nr. 93 datë 14.2.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për Prokurimet Publike*”, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kukës;
- Zelie Rexhmati, emëruar me urdhërin nr. 484 datë 29.9.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist për Prokurimet Publike*”, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kukës;

- Erjola Gjuta, emëruar me urdhërin nr. 62 datë 31.1.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Protokoll Arkivit*”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Kukës;
- Manuela Guri, emëruar me urdhërin nr. 622 datë 19.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist i Statistikave*”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Kukës;
- Haxhi Misini, emëruar me urdhërin nr. 616, datë 18.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Specialist*”, Drejtoria e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, në Bashkinë Kukës.

Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimi në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit.

B. Emërime në kundërshtim me ligjin në nivelin e lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues,
23 raste.

- Fadil Morina, emëruar me urdhërin nr. 573 datë 1.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, në Bashkinë Kukës;
- Emiriola Velia, emëruar me urdhërin nr. 972 datë 14.12.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Projekteve de Rinisë, në Bashkinë Kukës;
- Orgest Shehu, emëruar me urdhërin nr. 196 datë 2.4.2024 të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e IT, Komunikimit dhe Inovacionit, në Bashkinë Kukës;
- Gladiola Ismailaj, emëruar me urdhërin nr. 626 datë 9.4.2020, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Integrimit Europian, Diasporës dhe Emigracionit, në Bashkinë Kukës;
- Valdete Sinanaj, emëruar me urdhërin nr. 281 datë 4.6.2021, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i njesisë për Koordinimin e Integrimit Europian*”, Drejtoria e Integrimit Europian, Diasporës dhe Emigracionit, në Bashkinë Kukës;
- Klodian Korbi, emëruar me urdhërin nr. 578 datë 11.9.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Kontabilizimit dhe Shërbimit ndaj Taksapaguesve*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, në Bashkinë Kukës;
- Kujtim Dafku, emëruar me urdhërin nr. 603 datë 3.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Borxhit*”, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, në Bashkinë Kukës;
- Eklisa Korbi, emëruar me urdhërin nr. 108 datë 9.2.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Planifikimit të Territorit*”, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Kukës;
- Kristina Maklaj, emëruar me urdhërin nr. 237 datë 4.6.2021, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Administrimit të Pronave Publike*”, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Kukës;
- Shukri Shehu, emëruar me urdhërin nr. 315 datë 30.5.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, në Bashkinë Kukës;

- Besart Halilaj, emëruar me urdhërin nr. 551 datë 24.6.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Zhvillimit të bujqësisë dhe Akuakulturës*”, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, në Bashkinë Kukës;
- Sali Hallaci, emëruar me urdhërin nr. 142 datë 1.12.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Kukës;
- Albert Muja, emëruar me urdhërin nr. 917 datë 22.11.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, në Bashkinë Kukës;
- Iqert Kerxhaliu, emëruar me urdhërin nr. 180 datë 18.12.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Bashkim Guri, emëruar me urdhërin nr. 149 datë 7.3.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Aima Braha, emëruar me urdhërin nr. 345 datë 5.6.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*shef Sektori*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, në Bashkinë Kukës;
- Ramiz Heremi, emëruar me urdhërin nr. 669 datë 13.12.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Orsiola Braha, emëruar me urdhërin nr. 355 datë 6.6.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Shpenzimeve*”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Bashkinë Kukës;
- Alma Cengu, emëruar me urdhërin nr. 523 datë 15.6.2022, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit Juridik*”, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kukës;
- Durim Cenaj, emëruar me urdhërin nr. 615 datë 18.11.2024, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Kukës;
- Arjeta Gaxha, emëruar me urdhërin nr. 175 datë 18.12.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Statistikave dhe Performancës*”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Kukës;
- Lavderim Demnushi, emëruar me urdhërin nr. 567 datë 8.9.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, në Bashkinë Kukës;
- Albert Iseberi, emëruar me urdhërin nr. 179 datë 18.12.2023, të Kryetarit, në pozicionin “*Drejtor*”, Drejtoria e Rrugëve Rurale, në Bashkinë Kukës.

Kryetari i Bashkisë Kukës të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë së lartë, të mesme dhe të ulët drejtuese dhe të rregullojë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e rekrutimit dhe mobilitetit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit.

Njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset që, nëpunësit të cilët e gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në kategori më të ulëta të shërbimit civil, të rikthehen në pozicionet përkatëse, ku kanë qënë në momentin e daljes së aktit të kundraligjshëm për emërimin e tyre.

6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kukës, Prefekti i Qarkut Kukës, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kukës, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha